



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z.Znj. _____

Në bazë të nenit 53 për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të komunës së
Novobërdës:

Ftoj

Mbledhjen e ^{konkret} ~~parë~~ të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më 08.04.2025
(E marte) duke filluar në orën 10:00.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kalur.
2. Diskutim për emërtimin e rrugëve në komunën e Novobërdës
3. Te ndryshme .

Më: .2025

Në: Novobërdë

Shqipe Mustafa
Kryesuese e komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e ^{trete} Dytë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më: 10.02.2025 duke filluar nga ora 10:00.

Në takim morën pjesë: Kryesuesja e Komitetit për Komunitete Shqipe Mustafa, anëtarët e Komitetit : Dobrivoje Djordjevic, Violeta Miloshevic, Selatin Nuhiu, Edison Jashari, Igor Vasic, Vlora Vilasaliu, Zyrtari i Zyres për Kthim dhe Komunitete Fadil Llapashtica, Zyrtari i Drejtorisë për Arsim Flamur Uka, përfaqësuesit e OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit Shqipe Mustafa, pasi u uroi mirëseardhje të pranishmëve, konstatoi korumin, të pranishëm janë të gjithë antarët e komitetit dhe e filloi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kalur.
2. Diskutim rreth fillimit të gjysmëvjetorit të dytë mesimorë.
3. Njoftim nga zyrja për komunitete dhe kthim për planin e punës për vitin 2025
4. Diskutim rreth situatës gjatë vërshimeve dhe mirëmbajtjes së rrugëve nga bora
5. Diskutim i problemit të trotuarit në komunën e Novobërdës.
6. Të ndryshme .

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Komitetit.

Pika e dytë: Diskutim rreth fillimit të gjysmëvjetorit të dytë mesimorë

Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën Zyrtarit për Arsim Flamur Ukes.

Flamur Uka Ju faleminderit shumë, pershendetja për të gjithë drejtorinë e Arsimit ,kultures bazuar në kalendarin e veta për arsim kam nderin të ju raportoj për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit, këtë material pasi e keni të gjithë unë nuk po e lexoj të gjithën vetëm kisha kaluar në pikat kryesore ku ne i kalojmë më e rëndësishmja është se të gjithë nxensit po e vijojnë mesimin sipas kalendarit të M.Arsimit me të gjitha kushtet e nevojshme për mbajtjen e mesimit ,të gjitha shkollat janë të paisura me mjete higjienike,Nxemje me transport të nxensave etj.të pjesa e stafit aty ku kemi nevojë e sidomos të femrat që shkojnë në pushim të lehonis i bajmë zëvendësimet me kohë për këtë pjesë nuk kemi qka me raportu ma shumë për shkak se është pjesë vijuese e gjysmëvjetorit të parë ku ne fillim të vitit shkollor kemi siguruar

ngrohjet ,librat transportin e nxensve etj.e per ketë arsye nuk kamë diqka qka me specifiku ju faleminderit per mirëkuptim.

Kryesusja e komitetit po urdhero zotri Igor Vasis .

Igor Vasic: a ka perfundu procesi i furnizimit ne lend djegse me dru per shkolla apo e keni lënë në dy faza.

Kryesusja ju faleminderit zotri Uka .

Vazhdojm me piken e tretë .

Pika e tretë: Njoftim nga zyrja per komunitete dhe kthim per planin e punes per vitin 2025.

Kryesusja rrethë kesaj pike a kemi dikand nga Zyra per Kthim dhe Komunitete.

Këtë pikë e ka lypur Shefja e zyres per Kthim dhe Komunitete per miratimin e planit të punes per vitin 2025 ,fjalën po ja kaloj zyrtarit per Kthim dhe Komunitete zt,Fadil Llapashtica,urdhero

Fadil Llapashtica ju faleminderit,pershendetje per të gjithë,në emer të shefices zonja Jasmina denic ju kerkoj falje per mos prezencen e saj sepse ashtë në pushim mjeksor por nga ajo më është kerkuar qe nese mundeni ketë pik ta shtyeni per mbledhjen e ardhshme sepse ajo është e semur dhe nuk ka mundur me ardhën as në punë ju faleminderit per mirëkuptim.

Kryesusja Faleminderit Fadil ne i urojm zonjes Jasmina sherim sa me te shpejt dhe po e hedh në votim se kush është qe ketë pik ta shtyem per mbledhjen e rradhes, me vota nje zeri pro kjo pik kalon per diskutim në muajin e ardhshem ju faleminderit shumë.

Kalojmë në piken e rredhes ,

Pika e katërt: Diskutim rreth situates gjate vershimeve dhe mirembajtjes se rrugeve nga bora.

Keto dy pikat e fundit janë të propozuara nga drejtoria e sherbimeve publike por sot ata nuk janë ketu me neve dhe keshtu që unë propozoj qe edhe keto dy pika të kalojnë per mbledhjen e rradhes ju faleminderit pra kalojn per mbledhjen e rradhes edhe pika e katert dhe e pesta ju faleminderit,kalojmë në piken e gjasht .

Pika e pest: Diskutim i problemit te trotuarit ne komunën e Novoberdes.

Pika e Gjasht; Të Ndryshme

Kryesusja urdheroni

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.
Takimi përfundoi në orën 11.45.

Sylejman Abdyl
Procesmbartese

Shqipe Mustafa
Kryesuese e Komitetit per Komunitete

